

Siguri

# Ekskluzive: Mërgimtari kthehet nga Gjermania dhe e gjen shtëpinë të thyer në Gjakovë, i vidhet arma me fishekë



Sinjali.com

22 Qershor 2026 21:37



**Një rast i vjedhjes së rëndë është raportuar në Gjakovë, ku persona ende të panjohur dyshohet se kanë hyrë me forcë në një shtëpi dhe kanë vjedhur një armë me fishekë, mëson ekskluzivisht Gazeta Sinjali.**

Sipas burimeve të Sinjalit, rasti është raportuar më 22 qershor, rreth orës 07:00, në rrugën "Mark Malota" në Gjakovë.

Burimet bëjnë të ditur se ankuesi A.K., i cili jeton në Gjermani, ka deklaruar se shtëpinë e kishte lënë në rregull që nga muaji prill.

Mirëpo, kur është kthyer në shtëpi, ai ka vërejtur se dera e pasme ishte dëmtuar dhe dyshohet se ishte hapur me forcë.

Sipas deklarimit të ankuesit, brenda shtëpisë dollapët kanë qenë të hapur, ndërsa kur ka kontrolluar kutinë ku e kishte lënë armën, e ka gjetur vetëm kutinë.

Burimet thonë se nga shtëpia dyshohet se është vjedhur arma bashkë me 30 fishekë.

Ankuesi ka deklaruar se armën e kishte me leje, por leja i kishte skaduar më 9 shtator 2024 dhe ishte në procedurë për vazhdimin e saj.

Në vendin e ngjarjes kanë dalë patrulla policore dhe njësia e hetimeve, të cilat kanë kryer veprimet e nevojshme.

Lidhur me rastin është njoftuar Prokurori kujdestar, ndërsa rasti është iniciuar si "Vjedhje e rëndë".

Hetimet për identifikimin e personave të dyshuar dhe zbardhjen e plotë të rastit janë në vazhdim.

***Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!***

***/GazetaSinjali/***

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



## Lajme

Zgjedhjet 2026  
Kosovë  
Shqipëri  
Rajon  
Diasporë  
Evropë  
Botë

## Aktualitet

Politikë  
Drejtësi  
Siguri  
Shëndetësi  
Arsim  
Sociale

## Hulumtime

Ekskluzive  
Profile  
Skandaloze

## Ekonomi

Prodhime Vendore  
Financa  
Biznes

## Sport

Botërori 2026  
Futboll  
Basketboll  
Sporte Luftarake  
Sporte të tjera

## Showbiz

Bota e Yjeve  
Modë & Stil  
Bukuri dhe kujdes  
Të tjera

## OP-ED

Analizë  
Kolumne  
Intervistë

## Jetë

Fitnes  
Ushqime  
Travel  
Këshilla  
Receta  
Dieta  
Shëndeti

## Kulturë

Film  
Muzikë  
TV & Radio  
Libra  
Art & Dizajn  
Fotografi  
Histori

## Tech & Auto

Teknologji  
Automjete  
Telefona  
Internet  
Lojëra  
Aplikacione

## Fun

Qesharake  
Kuriozitete  
Kuize  
Fakte  
Të tjera